

VENDIM
Nr. 1086, datë 24.12.2020

**PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT PËR NDRYSHIM DHE SHITESË NË
MARRËVESHJEN E BASHKËPUNIT NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLË NË
FUSHËN E SIGURISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e protokollit për ndryshim dhe shtesë në marrëveshjen e bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunim të ndërsjellë në fushën e sigurisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

PROTOKOLL

**PËR NDRYSHIM DHE SHITESË NË MARRËVESHJEN E BASHKËPUNIT
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR BASHKËPUNIMIN TË NDËRSJELLË
NË FUSHËN E SIGURISË**

Bazuar në nenin 17, pika 3, të “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunim të ndërsjellë në fushën e sigurisë”, nënshkruar më 23.3.2015,

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Kosovës, bien dakord për sa vijon:

Në “Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunim të ndërsjellë në fushën e sigurisë”, nënshkruar më 23.3.2015, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas pikës 3, të nenit 1, shtohet pika “a”, me këtë përmbajtje:

“a) Palët angazhohen të bashkëpunojnë mes tyre edhe përmes përdorimit të përbashkët të Oficerëve të Kontaktit ose Ndërlidhës, në vendet ku njëra nga palët nuk përfaqësohet me Oficer Kontakti ose Ndërlidhës, me kusht që të jetë marrë pëlqimi i vendit pritës. Ky bashkëpunim nuk përfshin Oficerët e Kontaktit ose Ndërlidhës, pranë organizatave apo organizmave ndërkombëtarë, ku palët janë anëtare”.

Neni 2

Në nenin 4, “Autoritetet Kompetente”, për palën shqiptare, emërtimi “Ministria e Punëve të Brendshme”, zëvendësohet me emërtimin: “Ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë”.

Neni 3

Ky protokoll do të hyjë në fuqi ditën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, ku pala njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përmbushjen e procedurave të tyre të brendshme ligjore të kërkuara për hyrjen në fuqi.

Nënshkruar në Tiranë, më 2.10.2020, në dy origjinale, në gjuhën shqipe, të gjitha tekstet janë njëloj autentike.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Sandër Lleshaj
MINISTËR

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË
KOSOVËS
Agim Veliu
MINISTËR